REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I FINANCËS

Nr.455/1Prot

Pustec më 24.03.2026

PROJEKT-VENDIM
Nr.8 Datë 24.03.2026

KALIM INVESTIM ME OBJEKT "FURNIZIM ME UJË TË PIJSHËM PËR BASHKINË PUSTEC", SI SHTESË KONTRIBUTI NË ASETET E BASHKISË PRANË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 14 pika 5, neni 9 pika "c" dhe neni 23 pika 1, VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", pika 6 dhe pika 8, marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës-kanalizimeve (Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a.), nr. 5099 prot., datë 28.06.2022 dhe nr. 961 prot., datë 04.07.2022 (Bashkia Pustec), kontratës (marrëveshje bashkëpunimi për transferim aktiviteti), nr. repertori 5230, datë 12.09.2022, nr. koleksioni 3518, ndërmjet Shoqërisë sh.a. "Ujësjellës Kanalizime Bashkia Pustec" dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a., neni 1 pika 4, si dhe neni 2, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, ku shoqëria rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a. ka detyrimin të shlyejë të gjitha detyrimet e marra përsipër në bilancin e transferimit, si dhe të gjitha detyrimet e ardhshme që rrjedhin nga kontratat dhe angazhimet e kaluara apo aktuale të shoqërisë sh.a. Ujësjellës Kanalizime Bashkia Pustec, ku në rastin konkret kemi investimin "Furnizim me ujë të pijshëm për Bashkinë Pustec" (investim i bashkisë), si dhe shkresën zyrtare nr. 1912 prot., datë 17.12.2025 "Dorëzim dokumentash", Bashkia Pustec i dorëzon të gjithë dokumentacionin manual të investimit të projektit të ndërtimit të ujësjellësave në fshatrat e bashkisë, për të mundësuar transferimin e aseteve të krijuara pas lidhjes së marrëveshjes, i propozojmë Këshillit të Bashkisë.

TË MIRATOJ

1. Të miratojë kalimin e investimit me objekt "Furnizim me ujë të pijshëm për Bashkinë Pustec" me vlerë 562 544 975 lekë, si shtesë kontributi në asetet e Bashkisë Pustec pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a.
2. Ky investim, si pjesë e pasurisë publike të krijuar nga fondet e Bashkisë Pustec, të pasqyrohet në mënyrë kontabël si shtesë në kapitalin/kontributin e bashkisë në shoqërinë rajonale.

3. Ngarkohet Sektori i Financës, si dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Pustec, për ndjekjen e procedurave financiare dhe kontabël të kalimit të investimit, përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës, si dhe pasqyrimin e ndryshimeve në regjistrat e aseteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë Pustec.

PËRGJEGJËS I FINANCËS
Cvetko NASTO

KRYETAR I BASHKISË
Pali KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC